



Kosovo Career
Development Foundation



STUDIM GJURMUES RRETH PROJEKTIT “LEHTËSIMI I TRANZICIONIT TË NXËNËSVE NGA SHMU NË SHML”



KOMUNA E PEJËS

NËNTOR 2020

Studim gjurmues rreth projektit “Lehtësimit i tranzicionit të nxënësve nga SHMU në SHML”

Mbështetur nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Komunën e Pejës.

© Solidar Suisse, Pejë, Nëntor 2020.

© Fondacioni Kosovar për Zhvillim të Karrierës, Prishtinë, Nëntor 2020.

www.solidar-suisse-kos.org
info@solidar-suisse-kos.org
+383-39-421-411

www.koscdf.org
info@koscdf.org
+383-44-507-575

Përmbajtje

1	Hyrje	4
2	Mirënjohje	5
3	Metodologjia e studimit	6
4	Gjetjet e studimit gjurmues	7
3.1	Top profesionet e preferuara	7
3.2	Top profilet e zgjedhura në shkollë të mesme të lartë	8
3.3	Regjistrimi i nxënësve sipas shkollave të mesme të larta	9
3.4	Përputhja në mes të profesionit të përzgjedhur dhe profilit të regjistruar	10
3.5	Trendi i përputhjes dhe shpërputhjes	10
5	Rekomandime dhe përfundim	12

1 Hyrje

Ky raport ka për qëllim të paraqes ecurinë dhe gjetjet e studimit gjurmues në kuadër të projektit “Lehtësimi i tranzicionit të nxënësve nga SHMU në SHML” në Komunën e Pejës, i cili është implementuar nga Fondacioni Kosovar për Zhvillim të Karrierës – KCDF, me mbështetjen e Solidar Suisse dhe Drejtorisë Komunale të Arsimit në Pejë.

Faza të ndryshme të projektit janë karakterizuar me aktivitete të shumta rreth këshillimit dhe orientimit për karrierë dhe ndërmarrësisë. Prandaj, në fazën përmbyllëse të këtij projekti është zhvilluar një studim gjurmues për nxënësit që janë regjistruar në klasën e X-të në vitin shkollor 2020/2021, me qëllim të gjurmimit të tranzicionit të nxënësve nga shkolla e mesme e ulët në shkollë të mesme të lartë.

Në kuadër të projektit, nxënësit janë përfshirë në një sërë aktivitete të ndërlidhura me orientimin në karrierë, një prej të cilave ishte formimi i fokus grupeve të bazuara në profesionin e përzgjedhur nga nxënësit pas përfundimit të testeve të karrierës. Shërbimet e orientimit në karrierë janë ofruar tek afro 1,200 nxënës nga 27 shkolla të mesme të ulëta të komunës së Pejës, prej të cilëve nxënës 585 kanë deklaruar profesionin e përzgjedhur dhe 446 janë përfshirë në studim gjurmues.

Duke u bazuar në aktivitetet paraprake të projektit, gjurmimi është bërë për të kuptuar nëse ekziston dhe cili është niveli i përputhjes në mes të fokus grupeve të krijuara nga profesionet e zgjedhura dhe profileve në të cilat nxënësit e njëjtë janë regjistruar në shkollë të mesme të lartë.

Përmes këtyre indikatorëve, KCDF vlerësoi përbushjen e objektivave të projektit duke kontaktuar të gjithë nxënësit, përfshirë edhe ata që nuk kanë vijuar shkollat e mesme të larta. Si rezultatet, përmes këtij studimi KCDF do të informoj nxënësit, prindërit, mësimdhënësit, shkollat dhe institucionet vendimmarrëse, siç janë drejtoritë komunale të arsimit dhe ministritë, rreth gjendjes aktuale, ndikimit të këtij projekti dhe nevojave të nxënësve për drejtime të reja apo mbështetje në identifikimin e shtegut të duhur të karrierës.

2 Mirënjohje

KCDF shpreh mirënjohje dhe falënderim për bashkëpunimin e ngushtë dhe kontributin e vlefshëm në realizimin e studimit gjurmues për të gjithë nxënësit e klasave të IX-ta të vitit shkollor 2019/20 në Komunën e Pejës, mësime të shkollave të mesme të ulëta që kanë ligjruar në klasën e IX-të dhe janë të përfshirë në projekt, Këshillin Komunal për Orientim në Karrierë, koordinatorët e cilësisë dhe përfaqësues tjerë të shkollave të mesme të larta, prindërit, profesionistët e fushave të ndryshme që ofruan kontribut të vlefshëm duke prezantuar profesionet e tyre para nxënësve dhe Drejtorinë Komunale të Arsimit në Pejë së bashku me Solidar Suisse që kanë ofruar mbështetje për të gjitha aktivitetet e realizuara në kuadër të projektit.

3 Metodologjia e studimit

Projekti "Lehtësimi i tranzicionit të nxënësve nga SHMU në SHML" është ndarë në tri faza implementuese, gjatë të cilave janë realizuar një sërë aktiviteteve të ndryshme nga nxënësit e klasave të IX-ta të 27 shkollave të mesme të ulëta në Pejë. Respektivisht fazat iniciuese, implementuese dhe përmbyllëse janë shtrirë gjatë muajve Mars deri Shtator 2020.

Në fazën iniciuese, të gjithë anëtarët e Këshillit Komunal për Orientim në Karrierë (KKOK) dhe mësimdhënësit e fushës Jeta dhe Puna janë njoftuar rreth aktiviteteve të projektit dhe përfitimeve të shkollave. Në fazën implementuese janë përfshirë të gjithë nxënësit dhe mësimdhënësit e fushës përkatëse të klasave të IX-ta në realizimin e aktiviteteve, me qëllim lehtësimin e procesit të orientimit në karrierë, zhvillimin e tipareve ndërmarrëse dhe nxitjen e pjekurisë profesionale ndër ta. Nga rreth 1,200 nxënësit e përfshirë në këtë projekt, 585 prej tyre kanë deklaruar profesionin e përshtatshëm, i cili është identifikuar falë aktiviteteve dhe konsultave të ofruara nga projekti. Këta nxënës kanë përdorur kanale të ndryshme për ta deklaruar profesionin e përshtatshëm, siç janë: telefoni, grupi në Facebook, mesazhi, e-mail-i, Viber dhe platforma Busulla.COM.

Në fazën përmbyllëse është realizuar studimi gjurmues me 446 nxënës nga 585 nxënësit e përfshirë në mostër, të cilët kanë përfunduar shkollën e mesme të ulët në Qershor 2020 dhe kanë deklaruar drejtimin e regjistruar në shkollë të mesme të lartë për vitin shkollor 2020/2021. Rrjedhimisht, shkalla e përgjigjes së nxënësve në pyetësor është 76% ($446/585 = 76.2\%$). Ky studim është realizuar përmes disa kanaleve të komunikimit, ku si fillim është krijuar një pyetësor, pyetjet e të cilit kanë ndihmuar të kuptojmë rrjedhën e shtegut të karrierës që nxënësit e kanë ndjekur dhe konsistencën me profesionin e deklaruar në Qershor 2020.

Ky pyetësor është shpërndarë te nxënësit përmes mesazheve, grupit në Facebook, Viber dhe Koordinatorëve të Cilësisë së shkollave të mesme të larta, me qëllim që numri i nxënësve të përfshirë në studim të jetë sa më i lartë.

Të gjithë pyetësorët e plotësuar nga nxënësit janë agreguar dhe krahasuar në mes vete duke krijuar një listë finale prej 446 nxënësve. Përmes kësaj liste janë gjetur rezultate rreth përputhjes dhe shpërputhjes së zgjedhjes së nxënësve nga klasa e IX-të dhe X-të, të cilat shtjellohen në kaptinat në vijim të këtij studimi.

4 Gjetjet e studimit gjurmues

Përgjatë projektit nxënësit janë përfshirë në një sërë aktivitete, të cilat kanë ndihmuar ata të marrin një vendim të mirinformuar për zgjedhjen e shkollimit të mesëm të lartë, në përputhje me profesionin e identifikuar për të ardhmen.


Siç u shtjellua në kaptinën paraprake, gjatë fazës implementuese nxënësit janë regjistruar në platformën Busulla.COM dhe u janë nënshtruar testeve të karrierës, për të kuptuar cilat profesione janë më të përshtatshme konform interesave, prirjeve dhe aftësive të tyre. Përmes këtij aktiviteti, KCDF ka mbledhur rezultatet e të gjithë nxënësve dhe ka ardhur në përfundim që top 10 profesionet dominuese për nxënësit e klasave të IX-ta të vitit shkollor 2019/2020 në Komunën e Pejës janë si në vijim:

1. Mjek/-e
2. Arkitekt/-e
3. Aktor/-e
4. Infermier/-e i/-e përgjithshëm/-e
5. Dizajner/-e i/-e modës
6. Stomatolog/-e
7. Edukator/-e
8. Psikolog/-e
9. Mësimdhënës/-e
10. Farmacist/-e

Mbështetja e projektit për nxënësit e këtyre dhe tjera fokus grupeve ka vazhduar përmes eksplorimit të profesioneve në platformën Busulla.COM dhe përmes prezantimeve të mysafirëve folës, respektivisht profesionistëve eminent nga industritë e fokus grupeve të lartcekura.

3.1 Top profesionet e preferuara

Gjetjet e para që janë bërë me përfundimin e testeve të karrierës dhe deklarimin e profesionit të preferuar kanë rezultuar në formimin e 10 fokus grupeve të ndryshme nga 585 nxënës. Grafiku në vijim ilustron përqindjen e nxënësve të deklaruar sipas top 10 profesioneve:



Top 10 profesionet e përzgjedhura nga nxënësit


Sipas diagramit më lartë mund të kuptojmë që 25% e nxënësve kanë rezultuar të jenë më të përshtatshëm për profesioni mjek/-e, ndërsa profesionet pasuese rezultojnë të jenë arkitekt/-e me 11%, aktor/-e me 10%, infermier/-e i/-e përgjithshëm me 10%, etj.

Në platformën Busulla.COM ndarja e profesioneve është bërë në 13 fusha të edukimit. Këto fusha kanë për qëllim klasifikimin e profesioneve në grupe të gjera sipas veprimtarive të tyre të ndërlidhura. Nga këto fusha të edukimit kuptojmë që Shëndetësia dhe mirëqenia; Artet, shkencat humane dhe gjuha; dhe Arkitektura dhe ndërtimtaria janë 3 më dominuese tek nxënësit.

Disa nga top profesionet që bëjnë pjesë në fushën e Shëndetësisë dhe mirëqenies janë: mjek/-e, infermier/-e i/-e përgjithshëm, stomatolog/-e dhe farmacist/-e. Në fushën e Arteve, shkencave humane dhe gjuhës bëjnë pjesë profesionet: aktor/-e dhe dizajner/-e i/-e modës. Gjithashtu, në fushën Arkitekturë dhe ndërtimtari bën pjesë profesioni arkitekt/-e.

3.2 Top profilet e zgjedhura në shkollë të mesme të lartë

Pas të gjeturave të para, ku janë krijuar fokus grupet, në fazën përmbyllëse të projektit është realizuar edhe studimi gjurmues, ku nga 585 nxënësit e deklaruar për profesion janë përcjellë për të kuptuar nëse profili i zgjedhur në shkollë të mesme të lartë ndërlidhet direkt me profesionin apo të paktën me fushën e edukimit. Prandaj, 446 nxënës kanë deklaruar se në cilin profil të shkollës së mesme janë regjistruar në klasën e X-të në vitin shkollor 2020/2021. Prandaj, top profilet janë paraqitur përmes diagramit në vijim:



Top profilet e regjistruara nga nxënësit

Nga diagrami më lartë kuptojmë që drejtimi i shkencave natyrore është bindshëm më dominues me 34% nga 446 nxënës të regjistruar, drejtimi i shkencave shoqërore me 23%, profili infermieri e përgjithshme me 14%, pasuar me profilet automekanik, teknik i laboratorit, etj.

Është lehtë e kuptueshme që nxënësit gjatë këtij viti shkollor janë orientuar më së shumti në drejtime të gjimnazit. Kjo mbështet gjetjen e mëhershme lidhur me zgjedhjen e profesioneve nga nxënësit, ku kuptuam që profesioni mjek/-e ishte profesioni i parë në top 10 profesionet e nxënësve.


Megjithatë, diagrami po ashtu tregon që nuk është përzgjedhur asnjë drejtim apo profil i njëjtë apo i ngjashëm me profesionin aktor/-e. Kjo mbase është një gjetje e rëndësishme që arsimit mesëm të lartë në Komunën e Pejës nuk ofron drejtim apo arsim për nxënësit të cilët synojnë të zhvillojnë karrierë si

aktor/-e, edhe përkundër faktit që rezulton të jetë njëri nga top 10 profesionet e zgjedhura të nxënësve të përfshirë në këtë studim.

Ndërsa është e rëndësishme të cekim që për të gjitha profesionet tjera që nxënësit i kanë përzgjedhur si profesione të mundshme për karrierën e tyre, arsimiti i mesëm i lartë në Komunën e Pejës ofron së paku një drejtim apo profil që mbështet arsimin e nxënësve. Përveç nxënësve që kanë deklaruar që janë regjistruar në një shkollë të mesme, një përqindje prej afro 4% (apo 18 nxënës) nuk janë regjistruar fare për të vijuar shkollimin e mesëm të lartë. Studimi tregon që arsyet e mos-regjistrimit të nxënësve janë të ndryshme, ndër të cilat më të shpeshtat janë mospranimi në profilin e caktuar, mungesa e kushteve financiare ose mungesa e dëshirës për të vazhduar shkollimin e mëtutjeshëm.

3.3 Regjistrimi i nxënësve sipas shkollave të mesme të larta

Siç kuptuam nga diagrami paraprak, nxënësit më së shumti janë regjistruar në drejtimet e gjimnazit dhe mjekësisë, gjë që mund të shihet edhe në diagramin në vijim, ku janë të paraqitura përqindjet e nxënësve të regjistruar në shkollat e mesme të Pejës:



Regjistrimi në shkollat e mesme të larta


Prandaj, Gjimnazi "Bedri Pejani" është shkolla e mesme e lartë më e frekuentuar nga nxënësit e përfshirë në studim me 46% apo 205 nxënës të regjistruar në klasën e X-të nga nxënësit pjesëmarrës në këtë studim. Pastaj pasojnë shkollat:

- Shkolla e mjekësisë me 20% apo 89 nxënës
- Shkolla teknike "Shaban Spahija" me 19% apo 85 nxënës
- Shkolla e arteve "Odhise Paskali" me 10% apo 45 nxënës
- Shkolla ekonomike "Ali Hadri" me 4% apo 18 nxënës
- Shkolla e muzikës "Halit Kasapolli" me 1% apo 4 nxënës.

Numrat e nxënësve të regjistruar për vitin shkollor 2020/2021 nëpër këto shkolla janë nxjerrë nga numri total i nxënësve pjesëmarrës në pyetësinë e studimit, respektivisht 446 nxënës.

3.4 Përputhja në mes të profesionit të përzgjedhur dhe profilit të regjistruar

Njëra ndër gjetjet më të rëndësishme të këtij studimi është matja e përputhjes dhe shpërputhjes në mes të profesioneve të përzgjedhura të nxënësve në klasën e IX-të dhe profilit apo drejtimit në të cilin ata janë regjistruar në shkollë të mesme të lartë. Konsistenca e nxënësve në këtë proces është paraqitur përmes diagramit në vijim:



Përputhja dhe shpërputhja


Nga 446 nxënës, 50% apo 224 prej tyre kanë vazhduar shkollimin e mesëm të lartë në drejtime apo profile të cilat në mënyrë direkte apo indirekte ndërlidhen me profesionin e përzgjedhur, 46% apo 204 nxënës kanë vazhduar në drejtime që nuk ndërlidhen me profesionin e zgjedhur. Për më tepër, 4% apo 18 nxënës nuk kanë vazhduar me shkollim të mesëm të lartë fare.

3.5 Trendi i përputhjes dhe shpërputhjes

Studimi ka analizuar edhe trendët për profesionet të cilat kanë më shumë përputhje dhe shpërputhje në aspektin e përzgjedhjes së profesionit dhe regjistrimit në shkollë të mesme të lartë. Top 10 profesionet e përzgjedhura janë grupuar në fushat e edukimit përkatës dhe është analizuar ky trend. Fushat e edukimit të identifikuar sipas profesioneve të përzgjedhura janë:

- Arkitekturë dhe ndërtimtari – për profesionin arkitekt/-e
- Shëndetësi dhe mirëqenie – për profesionet mjek/-e, stomatolog/-e, infermier/-e i/-e përgjithshëm, dhe farmacist/-e
- Shkenca sociale, gazetari dhe informim – për profesionet mësimdhënës/-e, edukator/-e dhe psikolog/-e
- Shkenca natyrore, matematikë dhe statistikë – për profesionet mjek/-e, stomatolog/-e, infermier/-e i/-e përgjithshëm, dhe farmacist/-e
- Arte, shkenca humane dhe gjuhë – për profesionet aktor/-e dhe dizajner/-e i/-e modës

Diagrami në vijim shfaq ndërlidhjen e profesioneve të zgjedhura dhe drejtimeve të regjistruara në shkollë të mesme të lartë midis këtyre 5 fushave të edukimit, për të kuptuar nëse fusha të caktuara shfaqin ndonjë strukturë të caktuar, të ndryshme nga të tjerat:



Trendi i përputhjes dhe shpërputhjes

Këtu vërejmë që për fushat Shëndetësi dhe mirëqenie dhe Shkenca natyrore, matematikë dhe statistikë, ekziston një trend më i lartë i përputhjes. Kjo mund të jetë si rezultat i shumë faktorëve që ndikojnë në përzgjedhjen e karrierës, duke marrë parasysh mundësitë për të gjetur një vend pune, perspektivën në këto profesione, etj. Fushat e tjera kanë një përqindje më të lartë të shpërputhjes, mirëpo, fusha e Arkitekturës dhe ndërtimtarisë ka dukshëm një shpërputhje më të lartë në mes të profesionit dhe profilit të zgjedhur. Këtu mund të bëjnë pjesë një sërë faktorësh, që mund të jenë stereotipat rreth drejtimeve përkatëse në shkollat të mesme të larta, të cilat i dekurajojnë nxënësit që të regjistrohen nëpër këto shkollat apo drejtime.

Faktorë tjerë me rëndësi që ndikojnë në shpërputhjen e profesionit të preferuar dhe përzgjedhjes së profilit të shkollës së mesme të lartë mund të jenë ndikimi i familjes dhe shoqërisë ose mungesa e profileve të caktuara në shkollë të mesme të lartë. Për shembull, më lartë kuptuam që disa nxënës kanë zgjedhur profesionin aktor/-e gjatë implementimit të projektit, mirëpo ky profil nuk ofrohet në shkollat e mesme të larta në Komunën e Pejës.

Po ashtu, një faktor tjetër i mundshëm është mos-plotësimi i kriterëve për praninë në profilin e caktuar dhe kjo ka ndikuar që nxënësit të detyrohen të zgjedhin një profil tjetër, duke mos dashur të mbesin pa u regjistruar fare në shkollë të mesme të lartë.

Faktorë tjerë të rëndësishëm në vendimmarrje janë edhe ndikimi i prindërve dhe shoqërisë, të cilët mund të ndryshojnë qasjen tonë ndaj vendimeve të caktuara. Prandaj, është e rëndësishme që shkollat dhe institucionet vendimmarrëse të adresojnë politika dhe veprime që i ndihmojnë prindërit të kuptojnë rëndësinë e rolit të tyre në procesin e zgjedhjes së karrierës së fëmijëve. Në të njëjtën kohë, shkollat duhet që të punojnë edhe me nxënës, që ata të aftësohen t'i menaxhojnë ndikimet e prindërve, të afërmeve dhe shoqërisë në mënyrë kritike, në atë mënyrë që t'u lehtësohet dhe përmirësohet saktësia e vendimit për karrierë.

5 Rekomandime dhe përfundim

Realizimi i këtij studimi gjurmues ka përfshirë shumë bashkëpunëtorë të rëndësishëm, siç janë: shkollat e mesme të ulëta dhe shkollat e mesme të larta të Komunës së Pejës, Drejtorinë Komunale të Arsimit në Pejë dhe partneritetin në mes KCDF dhe Solidar Suisse.

Me bashkëpunimin e menaxhmentit të shkollave të mesme të ulëta dhe mësimdhënësve përkatës nga secila shkollë, janë mbledhur informatat për nxënësit e përfshirë në projekt. Një prej aktiviteteve të projektit ka përfshirë regjistrimin e nxënësve në platformën Busulla.COM dhe përfundimin e testeve të karrierës. Edhe pse të gjithë nxënësit i kanë përfunduar testet e karrierës dhe e kanë kuptuar profesionin e tyre të përshtatshëm, vetëm 585 kanë qenë të gatshëm që ta ndajnë këtë informatë me projektin. Rrjedhimisht, ky hulumtim përbëhet nga mostra prej 585 nxënësve, nga të cilët 446 nxënës janë përgjigjur në pyetësor.

Me anë të këtij studimi gjurmues kemi gjetur se cilat janë profilet që nxënësit kanë përzgjedhur për të vazhduar në shkollë të mesme të lartë, cilat janë shkollat e mesme të larta që kanë regjistruar më së shumti nxënës, sa është përputhja në mes të profesionit të preferuar dhe profilit të përzgjedhur dhe karakteristika tjera lidhur me profesionet dhe fushat e edukimit.

Prandaj, studimi gjurmues gjen që 50% e nxënësve janë regjistruar në profile apo drejtime të shkollave të mesme të larta të cilët janë në linjë me profesionet e zgjedhura. 46% e nxënësve kanë zgjedhur drejtime të ndryshme nga profesionet e deklaruara dhe 4% e nxënësve nuk e kanë vazhduar fare shkollimin e mesëm të lartë. Një rezultat i tillë është nxjerrë falë aktiviteteve të vazhdueshme të projektit përgjatë muajve Mars deri Qershor 2020. Prandaj, konsiderojmë që ofrimi në mënyrë sistematike i shërbimeve për këshillim në karrierë nga klasa VI deri IX, do të rriste numrin e nxënësve përfitues, të cilët në mënyrë të saktë e identifikojnë shtegun e karrierës.

Nga këto gjetje mund të kuptojmë që testet e karrierës dhe aktivitetet tjera të zhvilluara në kuadër të projektit kanë pasur ndikim pozitiv tek nxënësit, pasi që i kanë ndihmuar ata që të vendosin për shtegun e tyre të karrierës. Të njëjtët kanë dëshmuar që gjysma e tyre janë duke e ndjekur të njëjtin shteg, të identifikuar falë ofrimit të shërbimeve për këshillim dhe orientim në karrierë. Megjithatë, për 46% të nxënësve kuptojmë që kanë ndërruar vendim krahasuar nga deklaratimet e tyre në Qershor 2020. Për më tepër, për nxënësit të cilët kanë zgjedhur të mos e vijnë shkollimin e mesëm të lartë do të ishte e dobishme që në hulumtime tjera të identifikoheshin shkaqet e shumta të mundshme.

Për palët vendimmarrëse siç janë shkollat, drejtoria komunale e arsimit dhe ministritë është e rëndësishme që të kenë parasysh realizimin e analizave të tilla me numër sa më të madh të nxënësve. Një studim i tillë i vazhdueshëm do t'i ndihmonte këto institucione që të kuptojnë pritshmëritë dhe nevojat e nxënësve për drejtime dhe kualifikim. Rrjedhimisht, kjo do të siguronte që nxënësit gjejnë mbështetje tek shkollat publike të komunës për t'u aftësuar në fusha të caktuara, në të cilat ata aspirojnë të zhvillojnë karrierën e tyre.

Studime të tilla mund të zgjerohen edhe më tepër në të ardhmen për të kuptuar shkaktarët e shpërputhjes në mes të profesioneve të zgjedhura dhe drejtimeve apo profileve në të cilat nxënësit regjistrohen në shkollë të mesme. Kjo ndihmon që shkollat të kuptojnë nëse janë duke ofruar kapacitetet e nevojshme për drejtime të caktuara. Në të njëjtën kohë, do të ishte e dobishme të kuptohen profesionet e prindërve dhe pastaj të analizohet ndërlidhja në mes të profesioneve të prindërve dhe atyre të deklaruara nga nxënësit. Hulumtime të tilla ndihmojnë që të kuptojmë edhe rolin dhe ndikimin e prindërve në orientimin profesional të fëmijëve, i cili konsiderohet të jetë faktor i rëndësishëm në këtë proces.

www.solidar-suisse-kos.org
info@solidar-suisse-kos.org
+383-39-421-411

www.koscdf.org
info@koscdf.org
+383-44-507-575